



Duke u mbështetur në nenin 42.2 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale nr. 03/L-040, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Klinës, Kryetari i Komunës pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, bën këtë:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë anëtarët e zgjedhur të Kuvendit të Komunës së Klinës, institucionet komunale, Institucionet fetare, Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-ës, Media të shkruara, Radio "Alba" dhe të gjithë të interesuari të tjerë, se më datën 07 Dhjetor 2021, në Sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, do të mbahet Mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet duke respektuar masat e vendosura nga Qeveria e Kosovës, kundër virusit Covid-19

Në këtë seancë do të behët konstituimi i Kuvendit të Komunës së Klinës, si dhe do të bëhet dhënia e betimit të anëtarëve të ri të zgjedhur të Kuvendit dhe dhënia e Deklaratës së betimit solemn të Kryetarit të zgjedhur të Komunës.

Po ashtu në këtë seancë inauguruese do të behët zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës (sipas nenit 41 të LVL)

Pjesëmarrja e juaj në këtë seancë është e mirëseardhur.

01Nr. 06-42056 2021
Klinë, më 25. 11 2021

Kryetari i Komunës
Zenun Elezaj

